



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI I REPUBLIKES NE KOSOVES SKUPSTINA REPUBLICINE KOSOVA ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO	
Zyra për Propozime dhe Përcaktim të Kancelarisë së Vredësive / Table Office	
Mr. Prop. Nr. Prop. Proj. No.	05/2454/00-12/12
Nr. i fazeve Braj. sh. nr. ca No. pages	Data Datum Date 09.09.2016
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	

09 gusht 2016

Për: z. Isa Mustafa
Kryeministër i Qeverisë së Kosovës

Nga: Driton Çausi
Deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE
Kuvendi i Republikës së Kosovës

Lënda: Pyetje Parlamentare për përgjigje me shkrim

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigjeje me shkrim:

ÇËSHTJA: Z. Kryeministër, Komisioni për Punë të Jashtme në mbledhjen e mbajtur me 9 gusht 2016 vendosi që t'i shmang të gjitha procedurat e parapara të rregullta për ta proceduar Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Por kjo çështje u shtye për më shumë se tre javë për t'u proceduar në seancë.

Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur me 10 gusht 2016 e caktoi seancën plenare të rregullt për 1 shtator 2016 dhe e futi këtë projektligj në rend të ditës.

Në seancën e 1 shtatorit 2016, kur pritej të diskutohej dhe të hedhej në votim ky projektligj, ju e tërhoqët këtë projektligj nga rendi i ditës me arsyetimin tuaj (citim) "Qeveria e tërheq sot këtë projektligj nga rendi i ditës dhe procedura kuvendore. Do të mundohemi të arrijmë një qëndrim të përbashkët lidhur me ligjin, sepse konsideroj që nuk është në rregull që ta trajtojmë atë në situatën kur kemi presione dhe kërcënime, si dhe kur një grup parlamentar kushtëzon votimin e këtij ligji me koncesione. Nuk dëshirojmë të bëjmë asnjë koncesion për një ligj, i cili përcakton sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës. Tërheqja e këtij ligji nuk nënkupton që ne do ta rishqyrtojmë ose rinegociojmë marrëveshjen, por do të diskutojmë dhe do ta procedojmë në Kuvend, në momentin që vlerëson qeveria".

Ju nuk precizuat cilat kërkesa i ka bërë ai grup parlamentar (Lista Srpska) dhe kështu edhe dolët nga seanca.

Ndërkohë, me 7 shtator 2016 në një emision televiziv. Kryetari i Kuvendit z. Kadri Veseli njëherit edhe Kryetar i PDK-së tha (citim) "Unë nuk e di për çfarë kushtesh... unë nuk jam i njoftuar për asnjë kusht".

PYETJE PARLAMENTARE: Pyetja ime është, cilat ishin kushtet e Listës Srpska për të cilat ju thoni se janë koncesione në dëm të shtetit të Kosovës dhe pse Kryetari i PDK-së, partneri juaj, e thotë publikisht se nuk është në dijeni për kushtet e Listës Srpska! A ka pasur apo jo kushte të paraqitura nga lista serbe? Z. Kryeministër cila është e vërteta?